

**STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“ FRANKO TAXI ” SH.P.K**

**NENI 1**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria është quajtur “FRANKO TAXI” SHPK

Ajo është një subjekt shqiptar, të cilit i lind e drejta të ushtroje aktivitetin privat që nga data e regjistrimit ne Qendren Kombëtare të Bisnesit (QKB) Tiranë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe aktet e themelimit.

**NENI 2**  
**THEMELUESIT E SHOQËRISË**

Shoqeria FANKO TAXI SHPK krijohet me date 01/02/2025 nga ortaku i shoqërisë:

Françesko Hysenaj, atesia Mustafa , shtetas Shqiptar, lindur ne 12.01.1996 ne Vlore , banues ne Rr. Medar Shtylla nd 1845 H0 ap 010 ,0000 Tirane Shqiperi, identifikuar me ne leternjoftimi 032899146 dhe numer personal Nr ID J60112046Q me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

**NENI 3**  
**OBJEKTI**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj :

Sherbime Taksi per publikun si brenda territorit te Shqiperise dhe jashte saj.Transportin urban dhe interurban ne funksion te sherbimit taxi te udhetareve ne perputhje me cdo ligj te zbatueshem dhe rregulloreve te fushes perkatese.

Cdo veprim tjeter finanziar e tregtar qe lidhet ne menyre te drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e veprimtarise dhe qe eshte ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.



## **NENI 4**

### **SELIA**

Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Rruga ‘Rr. Medar Shtylla’ nr 1845 H0 ap 010 ,0000 Tirane Shqiperi

Shoqëria ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë filiale, agjensi përfaqësi etj dhe ti suprimojë ato me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Çdo ndryshim i selisë së shoqërisë do të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

## **NENI 5**

### **KOHËZGJATJA**

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje për një periudhë te pa kufizuar deri sa te vendoiset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme.

Ajo mund të shpërbëhet ne çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Shoqeria fiton personalitetin e saj juridik ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe nga kjo date ajo mund te filloje te ushtroje aktivitetin tregtar deri kur me vendim te Asamblese se Përgjithshme te vendoiset prishja e shoqerise ose kur shoqeria mbaron ne një nga menyrat e parashikuara ne ligjin “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

## **NENI 6**

Shoqëria do të ketë vulën e saj duke shenuar ne te emertimin tregtar ose iniciale.

## **NENI 7**

### **KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 leke (njeqind lekë) i ndarë në 1 (nje) kuote me vlerë nominale 100 leke (njeqind lekë), plotesh te nenshkuara dhe te shlyera.

Shoqeria FRANKO TAXI SHPK krijohet me date 01.02.2025 nga ortaku i shoqërisë:

Françesko Hysenaj , atesia Mustafa , shtetas Shqiptar, lindur ne 12.01.1996 ne Vlore , banues ne Rr. Medar Shtylla nd 1845 H0 ap 010 ,0000 Tirane Shqiperi, identifikuar me ne leternjoftimi 032899146 dhe numer personal Nr ID .J60112046Q me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar dhe kapitali i shoqerise i regjistruar ne pronesi te tij , eshte 100 leke qe i korrespondon 100% te kapitalit te shoqerise

## NENI 8

### **RRITJA DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR**

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me Vendim te Ortakut ,ne perputhje te kerkesave te detyrueshme te Ligjit te Shoqerive Tregtare.

Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te( i) kontributeve ne para ,(ii) kontributeve ne natyre ose (iii) perfshirjes se rezervave dhe te fitimit.

## NENI 9

### **TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR**

Pjeset e kapitalit transferohen lirisht midis ortakeve

Cdo transferim i kuotave do te behet ne perputhje me dispozitat e Ligjit te shoqerive Tregtare,si dhe ne baze te Mareveshjes se Ortakeve,dhe duhet te registrohet prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit

## NENI 10

### **MBYLLJA E SHOQËRISË**

Shoqëria mund të mbylljet me vendim të Asamblesë së Pergjithshme ose për çdo shkak tjetër të parashikuar në ligj.

## **ORGANET E SHOQËRISE**

### **NENI 11**

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

Asambleja e Pergjithshme, si organ kryesor i shoqerise sipas ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” pefaqesohet ne kete shoqeri nga ortaket.

Vendimet e Asamblesë së Pergjithshme do të merem me unanimitet.

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) përcaktimin e kushteve dhe rregullave për punësimin e personave të jashtëm sipas nevojave të Shoqërisë.çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

### **NENI 12**

#### **MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, pas mbylljes së vitit finanziar dhe kur aprovohet programi i veprimtarisë për vitin e ardhshëm.

Asambleja mund të thirret sa herë është ë nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërise.

Asambleja e përgjithshme mund të thirret në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga neni 82 i Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.



### **Menyra e thirrjes**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet n jë njoftimi me shkresë osë nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet tu dergohet ortakëve jo me vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës së siperpërmendur ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetem nëse ortakët janë dakort për të marre vendime pavarësisht parregullsisë.

### **NENI 13**

#### **PËRFAQËSIMI I ORTAKËVE NË ASAMBLËNË E PËRGJITHSHME**

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një një person i tretë.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila do të përfshijë dhe mbledhjet vijuese me të nejtin rend dite.

### **NENI 14 E DREJTA E VOTËS**

Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar të drejtën e një vote.

### **NENI 15 ADMINISTRATORI Emërimi dhe shkarkimi**

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Administratori i shoqerise do jete Françesko Hysenaj, atesia Mustafa, shtetas Shqiptar, lindur ne 12.01.1996 ne Vlore dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administratori qëndron në detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë përtëritje. Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

### Të drejtat dhe detyrat e administratorit

Kompetencat e Administratorit ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne :

Thirrjen e Asamblese se Pergjitheshme ,

Menaxhimin e aktivitetit tregtare te Shoqerise nepermejt implementimit te politikave dhe planeve nga Asambleja e Pergjitheshme.

Perfaqesimin e Shoqerise

Kujdesin ose mbajtjen ne menyre te pershtateshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise.

Pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor ,bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim Asamblese se Pergjitheshme.

Krijimin e nje sistemi paralajmerimi per rr Ethanat qe kercenojne mbarevajten e veprimtarise dhe te shoqerise.

Kryejne regjistimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare te regjistrimit kur eshte e nevojshme .

Raportimin perpara Asamblese se Pergjitheshme ,lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimtarive te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise.

Kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Ortaket.

### NENI 16

### TË DREJTAT E SHOQËRISË DHE ORTAKËVE

Shoqëria ka të drejtë të lidhë kontrata dhe të nënshkruajë marrëveshje brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur, duke u përjashtuar përgjegjësia personale e çdo ortaku. Në veprimet kontraktuale shoqëria përfaqësohet nga administratori i shoqërisë. Të drejtat dhe detyrimet që rrjehdin nga kontratat janë të detyrueshme për shoqërinë.



Ortakët përballojnë humbjet deri ne kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Ortaku ka të drejtë të marrë në çdo moment raportin e administrimit inventarët, llogaritë vjetore, për tre vitet e fundit financiare, duke qenë i ndihmuar po të jetë nevoja nga një ekspert i zgjedhur prej tij, i cili i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional.

Ortakët mund të caktojnë një përfaqësues ligjor për administrimin e çështjeve të veçanta ligjore, siç është p.sh. përfaqësimi në gjykatë etj. Honorarët vendosen në marrëveshje midis ortakëve dhe përfaqësuesit ligjor.

### **NENI 17**

#### **DIVIDENTËT**

Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me vendim të Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

### **NENI 18**

#### **VITI FINANCIAR**

Çdo vit finansiar fillor me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Pas imbarimit të vitit finansiar të cdo viti Administratori ose personat e caktuar prej tij janë të detyruar të paraqesin bilancin vjetor dhe deklaratën e të ardhurave dhe ti depozitojnë ato në Organin finansiar të Zyrës se Tatimeve.

### **NENI 19**

#### **MARREDHËNIET E PUNËS**

Mardhëniet e punësimit brënda shoqërisë rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në përputhje me ligjin nr 7961 dt 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” si dhe legjislativin tjetër shqipar që bën fjalë për punësimin.

**NENI 20**  
**MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.

Në rast të kundërt, ortakët do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ku Shoqëria ka selinë, për zgjidhje.

**NENI 21**  
**NDRYSHIMI I FORMËS SË SHOQËRISË**

Ndryshimi i formës së shoqërisë në një shoqëri me formë tjeter bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, kur plotësohen kushtet për krijimin e tyre.

**NENI 22**  
**LIGJI I ZBATUESHEM**

Kjo marreveshje rregullohet dhe interpretohet ne pertputhje me ligjet shqiptare.

**NENI 23**  
**TE TJERA**

Cdo ceshtje tjeter ,e cila nuk eshte e permendur ne kete statut ,do te regullohet nga dispozitata e ligjit “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “ dhe Marreveshja e Ortakeve.

Ky statut është hartuar në 2( Dy) kopje origjinalë ne gjuhen shqipe nga Ortaku themelues

*Françesko Hysenaj*

Françesko Hysenaj

